



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 01/10
Datë: 05.07.2020

Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbështetje të nenit 55 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, në zbatim të nenit 89 të Ligjit nr. 04/1-125 për shëndetësi dhe dispozitave të nenit 41 të Ligjit nr. 02/1-109 për parandalimin dhe luftimin e sëmundjeve ngjitëse, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 06/2020 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 07/2020, si dhe në zbatim të Vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr.01/11 datë 15.03.2020 për shpalljen e emergjencës për shëndetin publik, pas diskutimit me njësitë përkatëse në zbatim të rekomandimit të IKShPK-së dhe në pajtim me nenin 17 dhe 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 5 korrik 2020, merr këtë:

V E N D I M

1. Obligohet Ministria e Shëndetësisë dhe institucionet kompetente shëndetësore të rrisin kapacitetet me shtretër dhe pajisje mjekësore përkatës për të trajtuar rastet e prekura me COVID-19, përfshirë:
 - 1.1. Riorganizimin e klinikave në kuadër të SHSKUK-së duke krijuar shtretër dhe hapësira shtesë;
 - 1.2. Krijimin e kapaciteteve shtesë me shtretër dhe hapësira spitalore në spitale rajonale;
 - 1.3. Krijimin e kapaciteteve shtesë me shtretër dhe hapësira spitalore në institucione private shëndetësore në përputhje me ligjet në fuqi.
2. Obligohet Ministria e Shëndetësisë dhe institucionet kompetente shëndetësore të rrisin kapacitetet me personel shëndetësorë të nevojshëm për trajtimin e rasteve të prekura me COVID-19, përfshirë:
 - 2.1. Riorganizimin e personelit shëndetësor në shërbim të rasteve të prekura me COVID-19;
 - 2.2. Mobilizimi i stafit shëndetësorë në nivel vendi, duke përfshirë sipas nevojave edhe ata profesionistë shëndetësorë që nuk janë të angazhuar momentalisht;
 - 2.3. Në veçanti, të shtohen kapacitetet në shërbimin e mikrobiologjisë, infektologjisë dhe shërbimeve të tjera të lidhura drejtpërdrejt me rastet COVID-19.
3. Obligohet Ministria e Shëndetësisë dhe institucionet kompetente shëndetësore të ndërmarrin veprimet e nevojshme dhe të menjëhershme për të realizuar testimet virologjike, përfshirë:
 - 3.1. Shfrytëzimin e plotë të kapaciteteve ekzistuese për testim;
 - 3.2. Krijimin e kapaciteteve të reja testuese në regjione;
 - 3.3. Liçencimi i institucioneve private shëndetësore për të kryer testime për COVID-19, në përputhje me ligjet në fuqi;
 - 3.4. Prioritizim i testimit të personave më në nevojë.


4. Obligohet Ministria e Shëndetësisë dhe institucionet kompetente shëndetësore të ndajnë buxhetin e nevojshëm për blerjen e:
 - 4.1. Deri në 100,000 teste virologjike;
 - 4.2. Deri në 500,000 vaksina për gripin sezonal;
 - 4.3. Të bëhen porositë e nevojshme për vaksinën eventuale kundër COVID-19, në përputhje me protokollet e Komisionit Evropian dhe OBSH-së;
 - 4.4. Blerjen e 7 aparateve për testim;
 - 4.5. Blerjen e terapive specifike për trajtimin e të prekurve me COVID-19 në përputhje me protokollet e Komisionit Evropian dhe OBSH-së;
 - 4.6. Ndarjen e buxhetit për angazhimin e personelit shëndetësorë shtesë sipas nevojës;
 - 4.7. Pajisjeve mbrojtëse për personelin shëndetësor sipas nevojës;
 - 4.8. Pagesën shtesë për angazhimin shtesë të personelit shëndetësor.
5. Nga data 6 korrik 2020, duke filluar nga ora 21:00 deri në orën 05:00, ndalohet çfarëdo qarkullimi i personave fizik jashtë shtëpive/banesave të tyre në Komunitet: Prishtinë, Ferizaj, Prizren dhe Vushtrri, përveç:
 - 5.1. Në raste urgjente shëndetësore;
 - 5.2. Në rast të nevojës për t'u kujdesur për të sëmurë, për persona me nevoja të veçanta, vetëm nëse të sëmurët apo personat me nevoja të veçanta nuk kanë mundësi të kujdesen për vetveten;
 - 5.3. Në rast të kërkimit të ndihmës nga institucione përkatëse, siç është rasti me viktimat e dhunës familjare;
 - 5.4. Në rast të vdekjes së anëtarit të familjes;
 - 5.5. Në rast të paraqitjes së nevojave për dalje jashtë shtëpisë/banesës për nevojat fiziologjike të kafshëve, por jo më larg se 500 metra nga banesa/shtëpia (por, nuk lejohet shfrytëzimi i këtyre rasteve për të kryer ndonjë punë tjetër ose për ndonjë qëllim tjetër përveç atij të përcaktuar).
6. Institucionet publike dhe private në Republikën e Kosovës obligohen të reduktojnë numrin e të punësuarve vetëm në nivel të stafit të domosdoshëm (institucionet përkatëse do të sqarojnë me qarkore të veçanta se çfarë paraqet staf të domosdoshëm për to).
7. Institucioneve shëndetësore publike dhe private u rekomandohet të reduktojnë shërbimet shëndetësore jo esenciale.
8. Kërkohet nga të gjitha komunitet të ri-aktivizojnë plotësisht shtabet e tyre lokale.
9. Nga data 6 korrik 2020, të gjitha subjekteve që ofrojnë shërbime të gastronomisë (restorantet, kafiteritë, klubet e natës dhe të ngjashme):
 - 9.1. Iu ndalohet funksionimi nga ora 21:00 deri në 05:00 në gjithë territorin e Republikës së Kosovës;
 - 9.2. Jashtë këtij orari mund të punojnë vetëm në hapësira të hapura duke respektuar distancën prej 1.5 metra hapësirë ndërmjet tavolinave, si dhe shërbimet *take-away* (*merre me vete*).
10. Të gjitha subjektet që ofrojnë transport publik (autobusë, kombi, taksi) të punojnë me përgjysmim të kapaciteteve të tyre sa i përket numrit të udhëtarëve që bartin për të lejuar hapësirën e nevojshme për çdo udhëtar.
11. Obligohet Ministria e Shëndetësisë dhe institucionet përkatëse shëndetësore të ndërtojnë strategjinë adekuate mediale për informim të qytetarëve.

12. Në përputhje me kërkesat e Inspektoratit Sanitar, të gjitha inspektoratet e tjera i vënë në dispozicion kapacitetet e veta për të mbikëqyrë zbatimin e masave në përputhje me legjislacionin në fuqi.
13. Obligohet Ministria e Shëndetësisë të përgatisë "Planin e veprimit për zbatimin e procedurave të testimit me Covid-19" dhe ta sjell për miratim në Qeveri brenda një jave.
14. Ministria e Shëndetësisë përgatit dhe dorëzon në Qeveri në baza javore raportin për zbatimin e këtij vendimi.
15. Obligohen institucionet përkatëse të Republikës së Kosovës të ndërmarrin veprimet e nevojshme për zbatimin e këtij Vendimi.
16. Vendimi hyn në fuqi më 6 korrik dhe i njëjti vlen deri në një Vendim tjetër. Me hyrjen në fuqi të këtij Vendimi, shfuqizohet çdo dispozitë e mëparshme që bie në kundërshtim me dispozitat e këtij Vendimi.

ARSYETIM

Në javët e fundit janë rritur rastet e prekura me COVID-19. Kjo mund të shpie në përhapje masive të virusit, që do të qonte në mbingarkimin e sistemit shëndetësor me pasoja të rënda për shëndetin e qytetarëve. Andaj, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Avdullah HOTI



Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 02/10

Datë: 05.07.2020

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 06/2020 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 07/2020, në pajtim me nenin 17 dhe 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 5 korrik 2020, merr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet kërkesa e Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural për ndarjen e mjeteve financiare në vlerë prej 1,867.107,00 € (një milionë e tetëqindëgjatëdhjeteshtatë mijë e njëqindeshtatë euro), nga kategoria ekonomike Rezervat, të Kodit të Programit 11303 Departamenti i Financave dhe Shërbimeve të Përgjithshme, për kompensimin e dëmeve të shkaktuara në ekonomitë bujqësore nga fatkeqësitë natyrore elementare në Komunën e Istogut, Komunën e Pejës, Komunën e Obiliqit, Komunën e Vitisë, Komunën e Kaçanikut, Komunën e Gjakovës, Komunën e Vushtrrisë, Komunën e Klinës, Komunën e Rahovecit, Komunën e Mitrovicës, Komunën e Prishtinës, Komunën e Drenasit, Komunën e Skenderajt, Komunën e Prizrenit, Komunën e Fushë Kosovës, Komunën e Shtimes, Komunën e Podujevës, Komunën e Mamushës, Komunën e Leposaviqit dhe Komunën e Gjilanit.
2. Mjetet financiare të ndara nga pika 1. e këtij vendimi në shumën prej 25% ndahen nga fondi rezervë për dëmet eventuale në bujqësi.
3. Mjetet e ndara financiare i'u shpërndahen komunave të cekura në pikën 1. të këtij vendimi, bazuar në raportet e dërguara në Ministrinë e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, për fermerët përfitues që janë bujqit e dëmtuar, sipas raporteve të hartuara profesionalisht në teren nga ekipet profesionale përkatëse.
4. Obligohet Ministria e Financave, Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural dhe komunat përkatëse për zbatimin e këtij vendimi.
5. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Avdullah HOTI

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 03/10

Datë: 05.07.2020

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. të nenit 93 paragrafi (4) si dhe të nenit 55 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 89 të Ligjit Nr. 04/L-125 për Shëndetësi dhe të Ligjit Nr. 02/L-109 për Parandalimin dhe Luftimin e Sëmundjeve Ngjitëse, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 06/2020 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 07/2020, në pajtim me nenin 17 dhe 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, me qëllim të zbatimit të Vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 01/11, të datës 15 mars 2020 për shpalljen e Emergjencës për Shëndetin Publik, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 5 korrik 2020, merr këtë:

V E N D I M

Për plotësimin dhe ndryshimin e Vendimit të Qeverisë Nr. 02/08 të datës 23 qershor 2020

1. Pika 6. e vendimit të Qeverisë Nr. 02/08 të datës 23 qershor 2020 plotësohet dhe ndryshohet si në vijim: fjalia (vetëm vijat e rregullta të domosdoshme që kthehen brenda ditës) zëvendësohet me tekstin si në vijim: Fluturimet në ANP "Adem Jashari" do të organizohen në intervale prej minimum 45 minutave ndërmjet atertimeve. Menaxhimi i orareve të bëhet duke respektuar aplikimin e Rregullores Nr. 2008/6 Mbi Rregullat e Përbashkëta për Alokimin e Slloteve në Aeroportet e Vendosura në Kosovë, dhe rregullave të IATA (Worldwide Slot Guidelines, 10th Edition), Aeroplanët ad-hoc taxi nuk i nënshtrohen këtij rregulli.
2. Vendimi hyn në fuqi më 9 korrik 2020.

A R S Y E T I M

Në pajtim me situatën epidemiologjike në vend, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Avdullah HOTI

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë